

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Nr. 02-36/24-06

Prishtinë, më 30 nëntor 2006, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 80 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 16, 17 dhe 20 nëntorit 2006,
3. Koha për pyetje parlamentare dhe
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për buxhetin e Kosovës për vitin 2007.

Kryetari i njoftoi deputetët e pranishëm për rendin e ditës dhe për materialet e shpërndara për këtë seancë.

1. Miratimi i rendit të ditës

Për fjalë u paraqitën këta deputetë:

Deputeti **Ferid Agani**, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, kërkoi që në seancën e sotme të debatohet lidhur me vendimin për shtyrjen e zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Deputeti **Emrush Xhemajli** (LPK) e mbështeti kërkesën e deputetit Agani dhe kërkoi që seanca t'i ndërpresë punimet dhe të ftohet Grupi Negociator për të raportuar në Kuvend lidhur shtyrjen e zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Alush Gshi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, kërkoi të zbatohet Rezoluta e Kuvendit, miratuar më 17 nëntor 2005, në bazë të së cilës vepron Grupi Negociator. Në seancën e sotme të debatohet vetëm për projektligjin për buxhetin e vendit për vitin 2007.

Kryetari tha se kërkesën e Grupit Parlamentar për Integrim Kryesia e Kuvendit do ta shqyrtojë në mbledhjen e radhës dhe propozoi që seanca t'i vazhdojë punimet sipas propozimit të Kryesisë.

2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 16, 17 dhe 20 nëntorit 2006

Procesverbali i seancës plenare të 16, 17 dhe 20 nëntorit 2006 u miratua pa vërejtje.

3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Xhevat Bislimi** ia kishte parashtruar dy pyetje kryeministrit të Kosovës, z Agim Çeku, por ai nuk ishte i pranishëm në seancë për t'iu përgjigjur deputetit Bislimi.

Deputeti **Ferid Agani** i kishte parashtruar pyetje kryeministrit të Kosovës, z Agim Çeku, lidhur me përgjegjësin e ministrit të Shëndetësisë për mos zbatimin e ligjit për shëndetësi. Kryeministri Çeku nuk ishte i pranishëm për t'iu përgjigjur deputetit Agani.

Deputeti **Xhezair Murati** pyeti ministrin e Punës dhe të Çështjeve Sociale lidhur me pagesat e pensioneve, si dhe për përgatitjen e Projektligjit për sigurimin pensional dhe invalidor.

Ministri **Ibrahim Selmanaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Murati.

Deputetja **Gjylnaze Syla** pyeti ministrin e Ekonomisë dhe të Financave për moszbatimin e vendimit të Kuvendit të Kosovës, të miratuar më 7 korrik 2006, për pagesën e gjashtë milion € për pensionistët dhe invalidët e punës.

Ministri **Haki Shatri** iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputeti **Hydajet Hyseni** ripërsëriti pyetjen për Qeverinë e Kosovës lidhur me mënyrën shpenzimit të mjeteve për zbutjen e pasojave të tërmetit në komunën e Gjilanit, së cilës i shtoi pyetje shtesë: A i ka shqyrtuar Qeveria ankesat e qytetarëve për shfaqje të korrupsionit dhe të kriterëve partiake në ndarjen e mjeteve për zhdukjen e pasojave të tërmetit dhe nëse i ka shqyrtuar si i vlerëson ato?

Zëvendëskryeministri **Lutfi Haziri** iu përgjigj pyetjes së deputeti Hyseni.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit buxhetin e Kosovës për vitin 2007

Kryetari e ftoi sponsorin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri, **Haki Shatri**, në emër të Qeverisë së Kosovës, e paraqiti Projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2007.

Në vazhdim ministri Shatri tha se Kosova si vendi me ekonomi më të pazhvilluar në rajon, me probleme strukturale zhvillimore, me papunësi të theksuar, me varfëri dhe me infrastrukturë ekonomike të dobët, nuk mund të sigurojë nga burimet e veta vëllim të të hyrave buxhetore në pajtim me nevojat që kemi. Shkalla e ngarkimit të ekonomisë me **ngarkesa fiskale** sillet rreth **29%** dhe është afër kufirit të lejuar për ngarkesa të mëtejshme fiskale të **brutoproduktit vendor**. Të hyrat buxhetore për vitin 2007 janë për 4% më të mëdha sesa në vitin paraprak.

Projeksioni i të hyrave është avancuar në **682.8 milion €** dhe ky version është plotësisht i realizueshëm.

Në këtë Projektbuxhet ndryshon pozitivisht edhe struktura e të hyrave buxhetore duke dinamizuar rritjen e të hyrave në brendi për 12.5%, kurse ato që vilen në kufi për 2.9%. Të hyrat jotatimore dhe të hyrat vetanake të komunave janë projektuar më të ulëta se në vitin paraprak. Kufijtë e shpenzimeve buxhetore janë zgjeruar për 17.5 milion € ose për 2% në krahasimi me vitin buxhetor 2006.

Në këtë bilanc, që është vetëm nga të hyrat buxhetore, **deficiti buxhetor** i projektuar për vitin 2007 do të jetë **34 milion €** dhe do të mbulohet nga **keshi i rezervave** të Qeverisë, që në fund të vitit 2007 do të jetë **75 milion €**.

Struktura e shpenzimeve buxhetore në vitin 2007 do të ndryshojë dukshëm në favor të rritjes së investimeve kapitale, që janë rritur për 29 milion euro në krahasim me vitin 2006.

Si kategoria më e rëndësishme e shpenzimeve publike në vitin 2007, **investimet kapitale** kapin shumën rreth **199.7 milion €**.

Përmes rritjes së fondeve për investime, Qeveria ka siguruar bazën materiale për realizimin e prioriteteve të saj që lidhen me energjinë, ekonominë dhe edukimin. Për **energjinë** janë rekomanduar **21 milion €**.

Për arsimin qendror janë paraparë 34.3 milion € dhe granti për komuna 76.6 milion €, pra gjithsej **110.9 milion €**.

Për ndërtimin e rrugëve të reja dhe për rehabilitimin e rrugëve ekzistuese janë rekomanduar rreth **36 milion €**.

Linja buxhetore **për paga dhe mëditje** ende zë vendin e parë me **202.9 milion €**. Linja buxhetore **për mallra dhe shërbime** është zvogëluar për 8 milion euro dhe kap shumën prej **132.2 milion €**.

Linja buxhetore e **subvencioneve dhe transfereve** me rreth **154. milion €** mbulon transferet sociale, pensionet bazike dhe pensionet e tjera dhe nevojat e tjera emergjente.

Me buxhetin e vitit 2007 do të mbulohen shpenzimet e regjistrimit të popullsisë, zgjedhjet lokale dhe qendrore dhe përveç ruajtjes së nivelit të rezervës së Qeverisë dhe të PSSP-së

janë rezervuar edhe **4.5 milion €** për vazhdimin e procesit të negociatave dhe të nevojës së menjëhershme të passtatusit.

Me Projektbuxhetin e vitit 2007 nuk plotësohen nevojat dhe kërkesat e shumta të organizatave buxhetore, por ky projektbuxhet paraqet mundësinë tonë reale. Subjektet që na mbështesin dhe na monitorojnë na rekomandojnë sjellje me kujdes, përgjegjësi dhe mbikëqyrje rigoroze të shpenzimeve buxhetore.

Në fund ministri Shatri i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin Projektbuxhetin e vendit për vitin 2007.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri Shatri, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet e Financa dhe të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se Qeveria vazhdon të mos i respektoj afatet për dorëzimin e Projektligjit për buxhet, që janë të përcaktuara me Ligjin për menaxhimin e financave publike. Ai shprehu kënaqësi për disa trende pozitive që janë në këtë projektbuxhet.

Deficiti i përgjithshëm është zvogëluar nga 44 milion sa ishte në vitin 2006 në 30 milion për vitin 2007; ka një rritje të ndjeshme në fushën e investimeve kapitale, që janë në dispozicion 199.7 milion euro, për 19.3 milion euro më tepër se në vitin paraprak

Projektbuxhetit i mungon pasqyra e projekteve të investimeve kapitale dhe kërkoj nga Qeveria ta sjellë atë dokument, si dhe kornizën makroekonomike mbi të cilën është përgatitur buxheti dhe dokumentete tjera sqaruese, që mund të na ndihmoj në shqyrtimin e buxhetit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa do ta shqyrtojë me kujdes këtë projektligj dhe do t'i paraqesë Kuvendi me kohë raportin me rekomandime.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së tha se Projektbuxhetin për vitin 2007 e karakterizon një vlerësim joreal i burimeve të të hyrave, që fillon nga të hyrat e mbledhura në kufi, të cilat janë paraqitur në mënyrë sintetike, por i mungojnë të dhënat analitike.

Ne konsiderojmë se vlerësimi i drejtë i burimeve të të hyrave, menaxhimi efikas, zvogëlim i evazionit dhe e kontrabandës do të mundësonte që ne sot të diskutojmë të hyrat e tjera buxhetore.

Sa i përket shpenzimet buxhetore nuk dihet vlera parallogaritur e projekteve.

Nëse FMN-ja nuk lejon ngritjen e pagave për shërbimin civil, atëherë pse po lejohet ngritja e pagave në fuqitë e rezervuara?

Te pozicioni mallrat dhe shërbimet nuk ka specifikacionin të shpenzimeve.

Ne, si grup parlamentar, jemi të interesuar ta dimë se mbi ç'bazë janë projektuar mjetet financiare për shpenzime kapitale të ministrive.

Projektbuxheti nuk ofron sqarime si u ndahet komunave buxheti, çka merret parasysh? A ka të paraparë ndonjë stimulim buxhetor për komunat e varfra?

Ky projektbuxhet nuk ofron perspektivë për zhvillimin ekonomik të vendit.

Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se fondet që janë pasqyruar në këtë projektbuxhet nuk i plotësojnë të gjitha nevojat, por një menaxhim i mirë i tij mundëson përmbushjen e nevojave më të rëndësishme.

Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, në këtë projektbuxhet, ka demonstruar përkushtimin për disiplinë fiskale dhe stabilitet financiar.

Për Projektbuxhetin e vitit 2007 kemi edhe disa sugjerime:

E para, duhet siguruar mjete më të mëdha për fushën e arsimit dhe shëndetësisë.

E dyta, duhet siguruar fonde për zhvillimin e bujqësisë dhe të ekonomisë rurale.

E treta, mjetet e parapara për shpenzime dhe mallra, nëse nuk shfrytëzohen, duhen të alokohen për investime publike dhe zhvillim ekonomik.

E katërta, Kuvendit mos ta miratojnë buxhetin e paraparë për AKM-në pa pasur raport për shpenzimin e mjeteve të vitit të kaluar.

Grupi Parlamentar i AAK-së e mbështet në parim Projektbuxhetin për vitin 2007 me sugjerimet e dhëna.

Nazim Jashari, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, tha se në vazhdimësi po përsëritet që buxheti i Kosovës është buxhet i varfërisë, buxhet i fukarallëkut. Këtë sistem, që po e prodhon këtë buxhet të varfërisë, duhet ndryshuar. Kjo Qeveri dhe Ministri e Financave nuk e kanë kapacitetin e mjaftueshëm për ta ndryshuar këtë sistem. U mungojnë idetë, prej nga edhe fillon burimi i këtij buxheti të varfërisë.

Nëse e analizojmë buxhetin e vitit 2006 shohim se ka pasur keqmenaxhim, keqqeverisje, papërgjegjësi dhe gjitha këto sjellje me një automatizëm do të përcillen edhe për shpenzimin e buxhetit të vitit 2007.

Kosova e varfër, me vetëm 180 milion € për investime kapitale, e ka luksin që një milion € të jetë ngrië, që e bart nga një vit në tjetrin, kur kemi deflacion si pasojë e mungesës së parasë në qarkullim.

Ai u angazhua për një transparencë më të madhe për shfrytëzimin e buxhetit gjatë vitit 2007, veçanërisht për buxhetet e komunave, që vërehet një laramani në parashikim e shpenzimeve për zyrat e kryetarëve të komunave.

Xhezair Murati, në emër të Grupit Parlamentar 6 plus, tha se kao pripadnik manjih zajednica krenuo upravo od problema koji se vuku u ministarstvu koje nosi naziv Ministarstvo za Zajdenice i Povratak.

U ministarstvo za zajednice, mi nismo imali pristupa, niti imamo objašnjenja kako možemo doći do toga da u sredinama gde žive manje zajednice pomogne u smislu favorizovanja projekata koji se neće baviti povratkom, nego zadržavanjem.

Smatram da prioritet treba da bude zadržavanje pripadnika malih zajednica a potom je mnogo skuplja investicija u njegov povratak.

Ja bih ovom prilikom spomenuo još neke vitalne probleme za male zajednice, recimo nigde u budžetu ministarstva za obrazovanje nema stavke o subvencijama za izdavanje udbenika za manjite, tiraž je mali, ne isplati se njihovo štampanje.

Kao šef parlamentarne grupe 6+, uz sve primedbe koje su izneli, smatram da će Ministarstvo i Vlada uzeti u obzir sve ove ozbiljne primedbe i u načelu prihvatamo predlog budžeta za 2007. godine.

Numan Baliq, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, tha se u cjelini posmatrano budžet za 2007 naš je stav da postoji jedna tendencija statičnog prenošenja budžeta iz godine u godinu, ema dovoljno inventivnosti, nema značajni zaokreta i prmena koje bi vodile ka brzim usponima.

U vezi sa budžetom za Ministarsvo za poljoprivredu, šumarstvo i seoski razvoj (Kosovo je seosko područje gde je više od 60% je poljoprivredno područje) za razvoj sela izdvojeno 415.000 €. Od bužeta, koji ima 717 miliona €, manje od pola miliona € izdvoji za razvoj sela, to je nedopustivo.

U vezi sa Ministarsvom za transport i telekomunikacije za izgradnju novih puteva izdvojeno 8.5 milijna € a za opravku puteva, održavanje i rehabilitaciju puteva izdvojeno 18 miliona €. Vlada poseže, kao i ranije, za npopularnim mjerama.

U oblasti Ministarstva zdravlja ima krupne stavke koje su statično nepovoljne i ne obećavajuće. Vlada Kosovo nije u stanju da poveća plate u ukupnim civilnim službama. Plata jednog ljekara kod nas je 210 €, a u susedstvu imaju 800, 1500 i 2000 €, to je nedopustivo.

Za primarno zdravstvo izdvojena 455 hiljada €, znači manje od 1% od ukupnog budžeta Kosova, pa kako je moguće sa tako malim izdvajanjima da unaprijedimo granu koja obslužuje 80% svih pacijenata na Kosovu.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë këta deputetë: **Sabri Hamiti, Afrim Arzuallxhiu, Selvije Halimi, Bajram Kosumi, Ragip Zekolli, Sala Ahmetaj, Safete Hadërgjonaj, Ramadan Kelmendi, Gani Koci, Emrush Xhemajli, Teutë Hadri-Ramadani, Nexhat Rexha, Teutë Sahatçiu, Dritë Statovci, Mazllom Kumnova, Xhevdet Neziraj, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Behxhet Brajshori, Zahrije Jusufi, Berat Luzha, Florë Brovina, Ferid Agani, Bajrush Xhemajli, Hydajet Hyseni dhe Nafije Berisha**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, ministri **Haki Shatri** iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve lidhur me Projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2007.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votë miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 50;

Kundër-----26.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës e miratoi në parim Projektligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2007.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa – Komision Raportues - ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda afatit të përcaktuar me Rregullore të punës dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari seancën e deklaroi të mbyllur në orën 17:10.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë BERISHA

E hartoi

Spektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale